



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 80 prot.

Kamëz, më 17.06.2022

V E N D I M
Nr. 67 .Datë 17/06 2022
M B I

“MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË LISTËN E SUBJEKTEVE TË VENDIMEVE NR.54 , DATË 02.06.2020 DHE NR.87 , DATË 17.07.2020, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR NGA AKT-EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT ME NIVEL DËMTIMI “PËR SHEMBJE”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.06.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.64 Datë 16.06.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit” për shkak të tërmetit të 26.11.2019; Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.97, datë 19.02.2021 “për një ndryshim të Urdhërit nr.108, datë 24.02.2020 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Posaçëm të Rindërtimit, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në listën e subjekteve përfitues të Vendimeve të Këshillit Bashkiak nr.54 , datë 02.06.2020 dhe nr.87 , datë 17.07.2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

2. Lista e subjekteve që shfuqizohen, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
3. Lista e subjekteve që kualifikohen me nivele demtimi DS5 në bazë të akt akspertizave nga Instituti i Ndërtimit, janë të paraqitur në aneksin bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

Kryetar Këshilli
Hysen KOLDASHI